

**PËRMBLEDHJE E MINUTAVE TË MBLEDHJES
KËSHILLI I INVESTIMEVE (KI)
MBLEDHJA XXXI**

“Për Përmirësimin e Cilësisë së Shërbimeve Publike të Digjitalizuara ndaj Biznesit”

Tiranë, 6 tetor 2023, 11:00 – 12:30

Mbledhja u drejtua nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, z. Ervin Mete, Kryetar i KI. Në mbledhje morën pjesë 14 anëtarë të KI dhe rreth 30 vëzhgues – përfaqësues të shoqatave të biznesit vendas dhe të huaj dhe institucioneve shtetërore në Shqipëri.

Hapja e Mbledhjes nga Ministri Ervin Mete, Kryetar i KI

Në fjalën e tij hyrëse, Ministri Mete shprehu vlerësimin e tij për punën e Këshillit të Investimeve ndër viteve, duke e cilësuar atë si një platformë tripalëshe të suksesshme për diskutimin dhe shkëmbimin e ideve. Ministri Mete falenderoi ministren Ibrahimaj dhe Sekretariatit e Këshillit për punën e tyre, dhe shprehu mirënjohje ndaj BERZH-it për mbështetjen e ofruar. Më pas, Ministri Mete përmendi rezultatet pozitive të një vërtetimi të kryer nga Sekretariati lidhur me digjitalizimin, duke theksuar se bizneset shprehin ndërgjegjësime dhe kënaqësi me shërbimet online për arsye të uljes së barrës administrative dhe praktikave abuzive. Ai konfirmoi angazhimin e Qeverisë Shqiptare në drejtëm të përmirësimit të digjitalizimit dhe premtoi se rekomandimet e Këshillit do të trajtohen me seriozitet për të përmirësuar klimën e biznesit. Ministri Mete shprehu mirënjohje për pjesëmarrjen e gjerë në Këshill dhe besimin se komunikimi i ndërsjellë do t'i shërbejë të gjitha palëve. Më tej, ai bëri thirrje për përfshirjen aktive të anëtarëve të Këshillit në procesin e buxhetimit dhe hartimin e paketës fiskale për vitin 2024.

Prezantimi i analizës së Sekretariatit

Znj. Diana Leka (Angoni), Sekretariati i KI, prezantoi shkurtimisht gjetjet e studimit të përgatitur përmes konsultimit me përfaqësues të rëndësishëm të sektorit publik dhe privat, tre mbledhjeve konsultuese në nivel teknik me 55 pjesëmarrës, një punë kërkimore dhe një anketë online me 324 kompani. Studimi ofron 11 rekomandime që trajtojnë fusha të tilla si përgjegjësia e institucioneve për ri-inxhinierimin e shërbimeve, edukimi dhe ndërgjegjësimi i biznesit, kapaciteti digjital i administratës publike, siguria, asistenca, ankimi, pagesat online dhe teknikalitete të tjera.

Përmbledhje e diskutimeve kryesore

Ministri Ervin Mete, MFE, nënvizoi rëndësinë e diskutimit të bazuar në analiza dhe sondazhe me bizneset, të cilat tregojnë veçoritë e Këshillit të Investimeve në krahasim me platformat e tjera të ngjashme. Ai vlerësoi gjetjet dhe rekomandimet prezantuara në dokumentin e Sekretariatit dhe theksoi se këto rekomandime janë në përputhje me programin qeveritar dhe strategjinë Shqipëria 2030, miratuar së fundmi. Si procedurë, të gjitha komentet që do të dalin nga diskutimet do të mbahen shënim dhe do t'i bashkëngjiten rekomandimeve. Ai gjithashtu u shpreh se ka kërkuar nga Sekretariati një inventar të të gjitha rekomandimeve të pa-realizuara, me qëllim të vlerësimit të progresit dhe mundësisit të një koeficienti të realizimit në fund.

Z. Ervin Preçe, Pro Eksport Albania, u ndal në dy problematika kryesore:

- *Së pari*, çështja e kostove të lidhura me rinovimin e firmës digjitale dhe fiskalizimin. Ai shprehu mendimin se këto kosto duhet të përcaktohen në përputhje me një metodologji të njohur, e ndjekur edhe nga vendet e tjera. Preçe sugjeroi që këto kosto duhet të bazohen në pagën mesatare të punonjësve që do të përdorin këto shërbime. Ai theksoi që kostot aktualisht të aplikimit janë disproporcionale me realitetin, duke sjellë si shembull pagesën prej 4000 lekë për rinovimin e certifikatës elektronike për fiskalizim.
- *Së dyti*, vështirësitë teknike që ndodhin gjatë pagesave në bankë, për arsye të mungesës së terminologjisë. Për shembull, në raste kur subjekti paguan nga llogaria e biznesit, aplikimi refuzohet për arsye se nuk është specifikuar që pagesa është kryer nga llogaria e biznesit, duke e detyruar biznesin të ri-nisi procesin e pagesës nga e para dhe të humbasë afatet kohore. Preçe sugjeroi që kjo situatë mund të trajtohet me sqarime dhe bashkëpunim mes autoriteteve të përfshira dhe bizneseve. Ai propozoi që të konsiderohet mundësia për të krijuar një shërbim ekspres për ato biznese që dëshirojnë të marrin shërbimin më shpejt, edhe me pagesë shtesë, në mënyrë që të zbuten vonesat dhe të mundësohet që bizneset të mos ndikohen negativisht nga këto sfida.

Z. Enio Jaço, Dhoma Amerikane e Tregtisë, ngriti disa komente të përgjithshme në lidhje me shërbimet digjitale dhe shprehu vlerësimin për punën e KI dhe rolit që AmCham luan si pjesë e tij. AmCham ka ofruar rekomandime specifike për digjitalizim, duke e parë këtë proces si thelbësor për modernizimin e ekonomisë shqiptare dhe uljen e informalitetit dhe pastrimit të parave. Gjithashtu, vlerësoi iniciativën e KI për ndjekjen e rekomandimeve të paplotësuara si një mënyrë për të rritur produktivitetin e Këshillit.

Z. Ardian Lekaj, Dhoma e Biznesit të Diasporës, theksoi se në Shqipëri ka një problematikë të dukshme lidhur me “follow-up,” pra me ndjekjen e masave pas analizave të kryera, e cila është kritike për implementimin e rekomandimeve të Këshillit. Më tej ngriti dy çështje konkrete:

- Së pari, theksoi nevojën për *lehtësimin e procedurës së lëshimit të lejes së qëndrimit për të huajt*, veçanërisht kur administratori është i huaj. Kjo procedurë është e komplikuar dhe veçanërisht e vështirë për të huajt dhe hapja e një llogarie bankare është një sfidë e shtuar.
- Platforma e-albania është një sukses, por nevojitet *një profilizim i përdoruesve* për të dalluar nëse ata që përdorin këtë shërbim janë shqiptarë ose të huaj. Ky informacion është i rëndësishëm për të bërë një profil më të mirë të investitorëve dhe për të përmirësuar shfrytëzimin e fondeve të diasporës për zhvillimin ekonomik të vendit.

Ministri Ervin Mete, MFE, vlerësoi faktin që në Këshillin e Investimeve ka një përfaqësi të diasporës. Ai ndau mendimin se është e rëndësishme të rikonceptohet ndërlidhja e ekonomisë shqiptare me diasporën dhe flukset e shkëmbimeve me komunitetin e diasporës. Propozoi një kalim nga formatve e thjeshta të remitançave (“one-way street”) në formate më të avancuara të investimeve (“two-way streets”), ku fonde të kapitalit të investohen në vend dhe kontribuojnë në zhvillimin e vendit. Ky proces do të kishte përfitime të dyanshme, pasi jo vetëm që do të ndikonte në zhvillimin ekonomik të vendit, por gjithashtu do të kishte përfitueshmëri për ata që investojnë këto fonde. Në këtë frymë, ai sugjeroi organizimin e një takimi të posaçëm, i cili mund të organizohet nëpërmjet KI apo Dhomës së Diasporës, për të diskutuar rreth ngritjes së shkëmbimeve ekonomike, financiare dhe investimeve me diasporën në një nivel më të sofistikuar.

Znj. Natasha Ahmetaj, Banka e Shqipërisë, vlerësoi temën e diskutimit, duke përmendur se arsimit dhe inovacioni janë dy shtyllat që do të kontribuojnë në rritjen dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Ajo theksoi se Banka Qendrore ka qenë në krye të zhvillimeve në këtë fushë dhe ka kërkuar të ndikojë pozitivisht përpara se problemet të bëhen më të mëdha. Për këtë, ajo përmendi Ligjin e

Shërbimit të Pagesave, i cili përbën një ndërhyrje mjaft të rëndësishme në sistemin financiar të vendit. Ky ligj ka sjellë mundësinë për implementimin e një sistemi të avancuar dhe cilësisë më të mirë të shërbimit të pagesave, i ngjashëm me atë të vendeve të zhvilluara evropiane.

Miratimi i këtij ligji ka lejuar edhe miratimin e rregulloreve të nevojshme, përfshirë atë mbi mundësimin e Bankës së Hapur (“*open banking*”) dhe shtimin e agjentëve të shërbimit të pagesave. Kjo ka plotësuar nevojën për zgjerimin e shërbimit të pagesave në zona ku sistemi bankar nuk është ende efikas ose nuk ka arritur të mbulojë. Ajo gjithashtu tha se, ndonëse nuk ka informacion të saktë për çështjen, mundet që për të lehtësuar procesin, AKSHI po hulumton mundësinë e krijimit të një platforme të vetme të ndërfaqes me shërbimin e pagesave për pagesat online të shërbimeve publike¹.

Në lidhje me *open banking*, që pritet të hyjë në fuqi nga janari 2024, znj. Ahmetaj theksoi se kjo do të rrisë konkurrencën në sektorin e pagesave duke lejuar operatorë të tjerë të fusin në treg një funksion që më parë ishte i monopolizuar nga bankat. Ajo gjithashtu përmendi punën e nisur për integrimin e Shqipërisë në platformën e pagesave SEPA, e cila do të ulë komisionet për pagesat ndërkufitare për bizneset dhe individët dhe do të mundësojë uljen e kostos së këtyre pagesave.

Ministri Ervin Mete, MFE, theksoi rëndësinë e iniciativës SEPA dhe faktin se ajo është tashmë një iniciativë rajonale edhe në kuadër të “*Open Balkan*”. Ai gjithashtu përmendi faktin se në takimin e fundit të ministrave të financave të rajonit u diskutua për një mbështetje të Bankës Botërore në këtë drejtim. Z. Mete tha se Shqipëria është në një pozitë të përparuar në këtë fushë dhe se mund të ecë shpejt përpara për të përfituar nga ulja e kostos dhe lidhja me sistemet e tjera rajonale.

Në lidhje me hapjen e llogarive bankare për jo-rezidentët, ai theksoi se kjo do të kërkojë një analizë të hollësishme për shkak të lidhjes me elementë të pastrimit të parave. Ai propozoi një diskutim mes Bankës Qendrore dhe Agjencisë së Parandalimit të Pastrimit të Parave (nën MFE) për të adresuar këtë çështje dhe shprehu dëshirën që kjo të jetë një pikë diskutimi në mbledhjen e ardhshme të Këshillit të Investimeve.

Znj. Ines Muçostepa, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë, u shpreh se brenda një javë janë organizuar dy mbledhje në nivel të lartë për përmirësimin e shërbimeve publike. Kjo tregon se është momenti i duhur për të ndër marrë hapa të rëndësishëm në lehtësimin e kushteve të biznesit në Shqipëri. Ajo identifikoi disa sfida të rëndësishme:

1. “*Single window*” për importin dhe eksportin është një çështje e rëndësishme për bizneset që merren me tregti ndërkombëtare. Megjithatë, projekti i Bankës Botërore në këtë fushë duket se nuk është zbatuar me sukses në Shqipëri në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Ajo bëri thirrje që institucionet përkatëse, përfshirë Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, të marrin masa për të përmbushur këtë qëllim dhe të ndihmojnë bizneset që kërkojnë licenca për tregti ndërkombëtare.
2. Marrja e statusit “*eksportues i autorizuar*” mbetet një sfidë për shumë biznese. Ajo kërkoi mbështetje për trajnime dhe informacioni më të detajuar për këtë procedurë.
3. Në lidhje me *tregtinë elektronike*, nevojiten lehtësira për zhvillimin e dokumenteve elektronike, firmave digjitale dhe pagesave online.

Ajo gjithashtu përmendi disa arritje në fushën e prokurimeve, ndërsa shprehu nevojën që kërkesat e bizneseve të merren parasysh për të lehtësuar më tej këtë proces të rëndësishëm. Në fund, znj. Muçostepa falenderoi Sekretariatën për punën e bërë.

¹ *Sqarim i Shoqatës Shqiptare e Bankave (18 tetor 2023): Bankat po punojnë për realizimin e digjitalizimit të pagesave të shërbimeve publike, edhe pse projekti është jashtë afateve kohore të parashikuara. Synohet të testohet me një bankë fillimisht, dhe pastaj me bankat e tjera. Si “projekt pilot” është afër përfundimit.*

Ministri Ervin Mete, MFE, vuri në dukje se projekti i Bankës Botërore për lehtësimin e tregtisë, i cili aktualisht është në fazën e parë, po afron drejt përfundimit. Ai po diskuton hapa të tjerë të projektit në fazën e dytë, të cilat përfshijnë ndërhyrje në pikat kufitare dhe laboratorët e certifikimit. Këto ndërhyrje synojnë të adresojnë problemet që kanë penguar tregtinë dhe eksportin deri tani. Përveç Shqipërisë dhe vendeve të rajonit, projekti është planifikuar të shtrihet edhe në vendet që kufizohen me Ballkanin Perëndimor, duke mundësuar prekjen me tregun e Bashkimit Evropian.

Z. Mete theksoi se Shqipëria është e gatshme të diskutojë ndërhyrje të mëtejshme që do të lehtësojnë ndërlidhjet me tregjet rajonale dhe evropiane. Ai citoi parashikimet e Bankës Botërore për rritjen ekonomike të Shqipërisë, ku një nga sfidat është ndërlidhja më e mirë me tregun evropian. Në këtë kontekst, z. Mete ftoi për sugjerime dhe bashkëpunim organizatat dhe dhomat e tregtisë, me qëllim të përmirësimit të ndërlidhjeve dhe shkëmbimeve tregtare, pasi afërsia me tregun evropian ka qenë një faktor pozitiv për rritjen e ekonomisë shqiptare.

Z. Arben Shkodra, Bashkimi i Prodhuesve, theksoi dy çështje të rëndësishme të cilat nevojiten të analizohen dhe të diskutohen më gjerësisht:

1. *Cikli i mbyllur i digjitalizimit të shërbimeve*. Përmirësimet që janë bërë në digjitalizimin e shërbimeve hyrëse janë për t'u vlerësuar, por është e rëndësishme të vendoset një plan për mbylljen e ciklit të digjitalizimit që përfshin edhe përpunimin e të dhënave, të cilat vijojnë të jenë manuale nga administrata shtetërore. Ai theksoi se shumica e sipërmarrjes në Shqipëri përbëhet nga biznese të vogla dhe të mesme, të cilat kanë njohuri të kufizuara në digjitalizimin e shërbimeve, prandaj është e rëndësishme që të ekzistojë një plan i përbashkët midis qeverisë dhe donatorëve për të ndihmuar në edukimin dhe transformimin digjital të këtyre kompanive.
2. *Siguria digjitale*. Perceptimi i sipërmarrjes është se mund të mos ketë mjaftueshëm siguri digjitale. Ai propozoi ndërmarrjen e masave dhe zhvillimin e një plani transparent për sigurinë digjitale.

Ministri Ervin Mete, MFE, vlerësoi se çështjet e ngritura nga z. Shkodra lidhur me digjitalizimin e shërbimeve dhe kompanive janë sfida të rëndësishme. Ai theksoi se një prej sfidave kryesore është rritja e produktivitetit, e cila shoqërohet me nevojën për aftësimin e punonjësve për t'iu përgjigjur nevoja të biznesit, infrastrukturë, klimë të përshtatshme të të bërit biznesit dhe ndër to mbeten kryesore teknologjia dhe digjitalizimi. Z. Mete shprehu pajtimin e tij me këto çështje dhe tregoi gatishmëri për të diskutuar dhe marrjen në konsideratë të modeleve nga Evropa për të zhvilluar dhe implementuar reformën për digjitalizimin e bizneseve.

Ministrja Delina Ibrahimaj, Ministria e Shtetit për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit, vlerësoi platformën e hapur dhe periodike të KI për diskutimin e çështjeve të biznesit. Ajo theksoi rëndësinë e derregullimit dhe digjitalizimit të shërbimeve në Shqipëri dhe informoi mbi punën e qeverisë për të shkurtuar afatet dhe përmirësuar efikasitetin e dhënies së shërbimeve duke i bërë ato të disponueshme në mënyrë digjitale. Znj. Ibrahimaj po ashtu bëri një vlerësim të situatës së sigurisë kibernetike dhe njoftoi se janë ndërmarrë masa për të përmirësuar mbrojtjen dhe monitorimin e aktiviteteve të këtij lloji. Ajo gjithashtu theksoi rëndësinë e trajnimit të punonjësve të administratës publike dhe bashkëpunimin me biznesin për të siguruar që përdoruesit fundorë të kenë aftësitë dhe informacionin e nevojshëm për të përdorur sistemet digjitale me sukses.

Z. Artan Xhiani, Confindustria Albania, vlerësoi hapësirën e diskutimit të problemeve të biznesit dhe shprehu nevojën për një përshtetje të gjerë të bizneseve në këtë proces pasi ato kanë përfituar njohuri të gjera dhe kanë evidentuar probleme teknike në shërbimet digjitale. Z. Xhiani theksoi disa çështje konkrete për shqyrtim dhe përmirësim:

- *Self-Care*: Vlerësoi përpjekjet për përdorimin e “self-care”, por propozoi disa përmirësime, përfshirë nevojën për një përdorues të dytë për të mbrojtur të dhënat konfidenciale, afrimin e

datës së mbylljes së librave nga self-care, të rishikohen datat e faturave që i përkasin muajit parardhës, dhe përmirësimin e përdorueshmërisë së platformës. Po ashtu, theksoi nevojën për të lehtësuar rregullimin e TVSH-së në librat e blerjes.

- *QKB*: Ngriti disa problematika që kanë të bëjnë me aplikimet në QKB si p.sh. mungesa e instruksioneve të qarta për çdo aplikim, përgjigjet shabllon që nuk ndihmojnë përdoruesit të kuptojnë problemet, dhe probleme të ndryshme teknike dhe administrative. Nevojet një numër telefoni për të kontaktuar për shqyrtimin e çështjeve të pazgjidhura.
- *e-Albania*: Nevojitet krijimi i një përdoruesi të dytë me të drejta të rregulluara nga administratori për të përmirësuar aksesin dhe kontrollin.
- *Tatime*: Probleme që lidhen me detyrimet tatimore dhe vërtetime për shlyerjen e tyre, dhe theksoi nevojën për përmirësime që lehtësojnë raportimin dhe përpunimin e tyre nga kompanitë.

Z. Xhiani po ashtu bëri apel për më shumë bashkëpunim dhe komunikim me institucionet për të zgjidhur çështjet dhe për të shpejtuar përgjigjet ndaj kompanive.

Ministri Ervin Mete, MFE, i kërkoi Sekretariatit që të ftohen në mbledhjet e tjera përfaqësuesit e platformave respektive (QKB, AKSHI, etj.).

Ministria Delina Ibrahimaj, shpjegoi se në lidhje me çështjen e parë, disa ditë më parë u prezantua mënyra se si do të veprohet në të ardhmen. Institucionet shtetërore tashmë kanë punuar drejt lehtësimit të shërbimeve dhe kanë identifikuar rreth 64 institucione dhe 750 akte/procedura në të cilat ka nevojë për ndërhyrje për të reduktuar dokumentacionin ose procedurat administrative për ofrimin e shërbimeve. Takimi u mbajt me qëllim të informimit të biznesit dhe kërkesës së tyre përmes një pyetësoi, që pritet të jetë ndërmarrë nga Confindustria. Bizneset janë kërkuar që të identifikojnë ato që kanë nevojë për ndërhyrje.

Përfaqsa që planifikohet të ndiqet është që me analizimin e të dhënave të siguruara nga bizneset, të formohen ekipe me përfaqësues nga industritë specifike, ministritë e linjës që lidhet me shërbimin, me qëllim që të jenë sa më efikasë dhe të sigurohet vazhdimësia, siç u përmend më parë.

Znj. Ekaterina Solovova, BERZH, përgëzoi ministrin Mete për detyrën e tij të re dhe i shprehu urimet më të mira për suksesin e tij si kryetar i Këshillit të Investimeve. Ajo gjithashtu falenderoi ministren Ibrahimaj për detyrën e saj dyvjeçare si kryetare e KI-së. Shprehu mirënjohje ndaj Qeverisë Zvicerane/SECO për mbështetjen e vazhdueshme për Sekretariatit dhe angazhimin për zbatimin e disa prej rekomandimeve të KI. Znj. Solovova falenderoi gjithashtu të gjithë anëtarët e KI për pjesëmarrjen e tyre aktive, duke vlerësuar përpjekjet e tyre kolektive për ta bërë këtë platformë akoma më efektive.

Lidhur me digjitalizimin, znj. Solovova vuri në dukje se ky është një nga prioritetet strategjike të BERZH-it në shkallë globale, veçanërisht në drejtim të asistencës ndaj sektorit privat. BERZH ka ofruar një ndihmë të tillë përmes shërbimeve të konsulencës që synojnë rritjen e aftësive digjitale të NVM-ve, si dhe përmes mbështetjes për përmirësimin e platformës së e-Lejeve, krijimin e portalit të e-Fermeri, etj.

Ajo theksoi se në shumicën e vendeve ku operon BERZH, sektori privat priret të jetë më i avancuar në digjitalizim krahasuar me qeverinë. Ndërkohë, Shqipëria ka demonstruar një përparim unik, ku pothuajse të gjitha shërbimet publike janë të disponueshme online. Megjithatë, ka ende fusha për përmirësim, për shembull me Kadastrën ku sipas raportimeve nga bankat partnere në vend, ekzistojnë ende problematika që vonojnë dhe pengojnë kryerjen e transaksioneve.

Duke i konsideruar diskutimet gjatë kësaj mbledhje si shumë produktive dhe rekomandimet veçanërisht me vlerë për t'u konsideruar, znj. Solovova theksoi gatishmërinë e BERZH-it për të mbështetur zbatimin e disa prej rekomandimeve.

Z. Hubert Perr, Delegacioni i BE-së, përgëzoi për diskutimet mes sektorit publik dhe atij privat në këtë tryezë. Ai u shpreh mbi tre çështje:

1. *Raporti i ardhshëm i progresit*. Në këtë raport, BE vlerëson ecurinë në fushën e digjitalizimit duke theksuar rolin e tij në përmirësimin e efikasitetit, efektivitetit dhe transparencës. Digjitalizimi shihet si thelbësor për ofrimin e shërbimeve digjitale, formalizimin e ekonomisë, rritjen e transparencës dhe luftën kundër korrupsionit.
2. *Bashkëpunimi me partnerë*. Bashkëpunimi është një aspekt themelor i punës së Delegacionit të BE-së, me fokus përdorimin e digjitalizimit për arritjen e objektivave. BE është e angazhuar në mënyrë aktive në programe të ndryshme që synojnë promovimin e digjitalizimit. Studime të vazhdueshme nga BERZH dhe Banka Botërore po vlerësojnë mbulimin me internet *broadband* në Shqipëri, nga i cili do të përfitojnë bizneset. Gjithashtu, ekziston një studim i Komisionit Evropian që synon të investojë në laptopë për shkollat për t'i mësuar fëmijëve aftësi IT që në moshë të re. Bashkëpunimi me Kadastrën është në vazhdim, edhe pse paraqet sfida. Po bëhen përpjekje për të identifikuar mënyrat më të mira për të ofruar mbështetje në këtë drejtim. Një nismë tjetër e rëndësishme është zhvillimi i një sistemi të integruar të menaxhimit të çështjeve në fushën e drejtësisë. Rritja e efikasitetit, efektivitetit dhe transparencës në sistemin e drejtësisë ndikon drejtpërdrejt në mjedisin e të bërit biznesit.
3. *Përsheptimi i integritetit*, veçanërisht në fusha si pagesa SEPA dhe ulja e tarifave të roaming, është thelbësor për zhvillimin ekonomik. Për sa i përket zhvillimit ekonomik, BE është duke punuar për një plan rritjeje. Për të përsheptuar integritetin do të ketë mbështetje të përsheptuar edhe për vendet e Ballkanit në këtë proces.

Z. Agim Rrapaj, KASH, shprehu vlerësimin e tij për një nga rekomandimet e Sekretariatit lidhur me bujqësinë. Ai theksoi nevojën për kurajo në bërjen e rekomandimeve të tilla dhe shprehu mbështetjen për sugjerimin e Ministrit për të bërë një inventarizim të rekomandimeve të Këshillit. Ky inventar do të ofronte një pasqyrë në lidhje me ecurinë e rekomandimeve dhe suksesit të KI, si në vazhdimësi, ashtu edhe në të ardhmen.

1. Në lidhje me digjitalizimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB), u shpreh se ka *pakënaqësi* lidhur me shërbimet që ofrohen. Një rast i tillë është mungesa e efikasitetit të NIPT-it të Fermerit tek Drejtoria Industriale. Duhet të merret në shqyrtim rishikimi i të dy shërbimeve.
2. Sektori privat ka filluar tashmë të përdorë platforma elektronike dhe duhet të theksohet *përdorimi i portalit të BERZH-it për fermerët*. Megjithatë, është e rëndësishme që këto dy platforma të bashkëpunojnë për të plotësuar njëra-tjetrën. Ata duhet të punojnë sëbashku për të adresuar një hendek në këtë sektor, i cili lidhet me mbledhjen dhe shpërndarjen e të dhënave. Kjo ndodh më mirë në platformat private.
3. Është e rëndësishme të kemi *një buxhet të dedikuar* për mirëmbajtjen e këtyre platformave. Ministria e Bujqësisë ka një buxhet të caktuar dhe do të ishte e domosdoshme që Ministria e Financave dhe Ekonomisë ta monitoronte atë për sigurimin e fondit të nevojshëm për procesin e digjitalizimit. Ka pasur raste të keqkuptimeve me buxhetin e përcaktuar nga Banka Botërore për digjitalizimin e sektorit të blegtorisë. Në mungesë të një buxheti të specifikuar, sistemi do të vijojë të funksionojë në mënyrë të kufizuar.

Ministri Ervin Mete, MFE, shprehu nevojën për organizimin e një takimi të posaçëm me Ministrinë e Bujqësisë, ku të trajtohen çështje që kanë të bëjnë me bujqësinë, përfshirë aspektet buxhetore, paketën fiskale dhe Census-in aktual që po kryhet nga INSTAT. Census-i pritet të

ofrojë informacion të rëndësishëm për sektorin e bujqësisë. Ministri Mete përmendi rëndësinë e sektorit bujqësor si një kontribues i fuqishëm në Produktin e Brendshëm Bruto (GDP). Ai gjithashtu propozoi një takim të përbashkët me partnerët për zhvillim, përfshirë BERZH, Delegacionin e Bashkimit Evropian dhe Bankën Botërore, për të diskutuar dhe adresuar çështjet që lidhen me bujqësinë.

Znj. Diana Leka, Sekretariati i KI, sqaroi se monitorimi i rekomandimeve të KI është një funksion i mirëfilltë në Sekretariat prej 4 vitesh, ku raportohet në mënyrë sistemi tek anëtarët e KI në lidhje me progresin e rekomandimeve. Raporti i rekomandimeve tregon se në cilat aspekte është bërë progres, dhe në cilat vazhdohet puna për zbatimin e tyre. Më specifikisht, me kërkesë të Kryetarit të ri të KI, javën e kaluar Sekretariati ndërmori një analizë të thelluar të rekomandimeve që janë ende të paplotësuara. Katër rekomandime që janë ngritur si prioritare janë:

1. *Cështja e informalitetit* – Hartimi i një strategjie kundër informalitetit dhe impakti i saj.
2. *Stabiliteti i legjislacionit fiskal* – Ndryshimet e vazhdueshme dhe impakti i tyre tek subjektet dhe buxheti i shtetit.
3. *Strategjia e eksporteve dhe mundësia e krijimit të një portali për eksportet* – Gjendja aktuale dhe hapat që duhen ndërmarrë në këtë drejtim.
4. *Draft ligji i unifikuar i investimeve*.

Gjithashtu, znj. Leka informoi se, me kërkesë të Kryetarit të ri të KI, tematika për mbledhjen e ardhshme për vitin 2023 u hodh për votim tek anëtarët dhe dy temat më të votuara ishin:

1. *Stabiliteti i legjislacionit fiskal* – Analiza e impaktit dhe ndryshimet në legjislacionin fiskal.
2. *Maksimizimi i potencialit të investimeve* – Investimet nga investitorët vendas, të huaj dhe diaspora & impakti i tyre në rritjen e vlerës së shtuar në vend.

Ministri Ervin Mete, MFE, falenderoi për informacionin dhe theksoi nevojën për më shumë detaje në dhënien e rekomandimeve të KI. Ai u shpreh se disa nga temat e rekomandimeve janë tepër të gjera, siç është rasti me informalitetin dhe stabilitetin e legjislacionit fiskal. Për t'i trajtuar me efikasitet, ministri theksoi se është e rëndësishme të shqyrtohen më në detaje aspektet e tyre. Për shembull, për temën e informalitetit, duhet të identifikohen aspektet konkrete që mund të adresohen dhe rekomandimet specifike që janë ngritur dhe si janë adresuar. Gjithashtu, për stabilitetin e legjislacionit fiskal, duhet bërë një analizë më e thellë për të parë cilat ndryshime janë bërë më shpesh, cilat prej tyre nuk kanë funksionuar si pritëshin dhe cilat ndryshime duhet të jenë më të qëndrueshme ose të mos ndryshohen fare.

Mbyllja e mbledhjes

Në përfundimin të të gjitha komenteve, Ministri Mete falenderoi pjesëmarrësit për kontributin dhe e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

Lista e pjesëmarrjes

Përfaqësues të qeverisë

1. Z. Ervin Mete, Kryetar i Këshillit të Investimeve/Ministër i Financave dhe Ekonomisë
2. Znj. Delina Ibrahimaj, Ministër Shteti për Sipërmarrjen dhe Klimën e Biznesit
3. Znj. Natasha Ahmetaj, Zëvendës Guvernatore e Bankës së Shqipërisë
4. Znj. Laura Plaku, CEO, AIDA

Përfaqësues të biznesit

1. Z. Loritan Prespa, Nënkryetar, deleguar nga z. Nikolin Jaka, Kryetar, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë
2. Znj. Ines Muçostepa, Kryetare, Bashkimi i Dhomave të Tregtisë dhe Industrisë
3. Znj. Antonela Hako, Kryetare, Dhoma Ekonomike e Gruas (DHEG)
4. Z. Arben Shkodra, Sekretar i Përgjithshëm, Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë
5. Z. Enio Jaço, Kryetar, AmCham Albania
6. Z. Ardian Lekaj, Kryetar, Dhoma Shqiptare e Biznesit të Diasporës
7. Z. Agim Rrapaj, Kryetar, KASH (*ad-hoc*)
8. Z. Doranin Agalliu, Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar (IEKA) (*ad-hoc*)

Partnerë ndërkombëtarë

1. Znj. Ekaterina Solovova, Drejtore e Zyrës së BERZH-it në Shqipëri
2. Z. Hubert Perr, Shef i Bashkëpunimit, Delegacioni i BE-së

Nuk morën pjesë:

1. Z. Emanuel Salinas, Menaxheri i Zyrës së Banka Botërore në Tiranë
2. Znj. Laura Qorlaze, Përfaqësuese, IFC
3. Z. Bilal Kara, Kryetar, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Shqipëri – Turqi (ATTSO)

Të ftuar të veçantë:

1. Znj. Vasilika Vjero, Zv/Ministër i Financave dhe Ekonomisë
2. Z. Endrit Yzeiraj, Zv/Ministër i Financave dhe Ekonomisë
3. Z. Philipp Arnold, zëvendësshëf i Misionit në Ambasadën e Zvicrës

Të ftuar të tjerë:

Ish anëtarë të biznesit në KI

1. Z. Artan Xhiani, Anëtar Bordi/Ekspert, Confindustria Albania
2. Znj. Gerta Bilali, Drejtore Ekzekutive, Confindustria Albania

Përfaqësues të tjerë

3. Z. Edvin Preçe, Kryetar, Shoqata Pro-Eksport Albania (PEA) (*ad-hoc*)
4. Z. Neritan Mullaj, Drejtor Ekzekutiv, AmCham Albania
5. Znj. Linda Shomo, Kryetare e Komitetit të Digjitalizimit, AmCham Albania
6. Znj. Alda Bakiri, Sekretare e Përgjithshme, Dhoma Italiane e Tregtisë dhe Industrisë
7. Znj. Marlinda Zotaj, Drejtore Ekzekutive, Advantage Austria
8. Znj. Ardita Seknaj, Sekretare e Përgjithshme, ICC Albania

9. Z. Denald Tafani, Kryetar, Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri
10. Znj. Esmeralda Ballesha, Center for International Private Enterprise (CIPE)
11. Z. Bashkim Sykja, Drejtor Kabineti, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë
12. Znj. Albana Laknori, Sekretare e Përgjithshme, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë, Tiranë
13. Znj. Adelinda Farriçi, Sekretare e Përgjithshme, Shoqata per Autonomi Vendore
14. Z. Aleko Proko, Drejtor Ekzekutiv, Shoqata e Prodhuesve
15. Z. Gledis Shehu, Ekspert i Pavarur
16. Znj. Nuriona Bërdica, Eksperte e Pavarur
17. Z. Reinaldo Pipiria, Kryetar, Shoqata e Pasurive të Patundshme
18. Z. Dritan Mezini, Kryetar, AITA
19. Znj. Brunilda Kostare, Këshilltare Juridike, Shoqata e Bankave
20. Z. Ervin Avrami, Nën Kryetar Bordi, Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë
21. Znj. Soana Jaupllari (Tekla), Përfaqësuese, Dhoma Shqiptare e Biznesit të Diasporës
22. Znj. Tiziana Domi, Koordinatore Projekti, SWISSA
23. Z. Keler Gjika, Ekspert Fiskal, Banka Botërore
24. Znj. Desarta Rapushaj, Drejtore e Departamentit të SME-ve
25. Znj. Sigita Stafa, Manaxhere Programi, Ambasada e Zvicërës në Shqipëri
26. Znj. Ledia Muço, Këshilltare për Çështjet Ekonomike, Delegacioni i BE-së
27. Znj. Endrita Xhaferaj, Eksperte, BERZH